



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 70

Tiranë – E mërkurë, 5 prill 2017

## PËRMBAJTJA

|                                                             | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|-------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 245, datë 29.3.2017 | Për dhënien me qira, me tarifë të reduktuar, të sallës së koncerteve të Pallatit të Kongreseve, Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor..... 4293                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 246, datë 29.3.2017 | Për një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 4293                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 247, datë 29.3.2017 | Për transferimin në pronësi të Bashkisë Pogradec, në njësinë administrative Çërravë, të pasurisë me nr. 77, në zonën kadastrale 2420, me sipërfaqe 5 900 m <sup>2</sup> dhe për një ndryshim në vendimin nr. 417, datë 8.6.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Çërravë, të qarkut të Korçës” ..... 4294 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 250, datë 29.3.2017 | Për lirim, mandatimin dhe rimandatimin e disa anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit..... 4296                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 251, datë 29.3.2017 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 7, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2017 në njësitë e qeverisjes qendrore” ..... 4296                                                                                                                                                                                                                                               |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 259, datë 29.3.2017 | Për një ndryshim në vendimin nr. 681, datë 28.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë–Elbasan (rrëshqitja në fshatin Ibë)”” ..... 4297                                                                                                                                                              |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 260, datë 29.3.2017 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 500, datë 6.7.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil”, të ndryshuar..... 4298                                                                                                                                                                                                                                  |

|                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |      |
|--------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 261, datë 29.3.2017        | Për një shtesë në vendimin nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagesë të qirasë për disa familje që preken nga zbatimi i projektit “Unaza e madhe e Tiranës”, segmenti “Komuna e Parisit–Rruga e Kavajës””, të ndryshuar.....                                                                                                                                     | 4298 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 262, datë 29.3.2017        | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 661, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, “Skelë–Uji i Ftohtë, Bashkia Vlorë”, të ndryshuar” .....                                                                                                    | 4299 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 264, datë 29.3.2017        | Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia Tiranë, të pasurisë me nr. 2/377, vol. 37, f. 133, ZK. 8380, me emërtim “Godinë njëkatëshe” e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.....                                                                                                                                              | 4299 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 265, datë 29.3.2017        | Për transferimin e pronësisë së 45.11% të kuotave të shoqërisë “Qendra Tregtare e Zhvillimit Kulturor” sh.p.k., Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia e Tiranës.....                                                                                                                                                                           | 4303 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 266, datë 29.3.2017        | Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “Rozafa” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “objekte dhe truall, të Agjencisë së Rezervave Materiale të Shtetit Labinot, Elbasan (pjesa e mbetur)”, të Ministrisë së Punëve të Brendshme..... | 4303 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 269, datë 29.3.2017        | Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit.....                                                                                                                              | 4310 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 271, datë 29.3.2017        | Për lëvizjen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 18 veprave të artit në pikturë dhe vizatim, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, me qëllim realizimin e ekspozitave “Documenta 14”, që do të zhvillohen në ambientet e Muzeut Kombëtar të Artit Bashkëkohor Athinë, Greqi, dhe në Muzeun e Arteve të Bukura, <i>Neue Galerie</i> , Kassel, Gjermani.....                    | 4312 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 274, datë 29.3.2017        | Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullësor publik dhe pakësimin në volum të sipërfaqes prej 21.56 ha, në objektin “Hotolisht”, Bashkia Librazhd, që do të përdoret nga shoqëria “Rosi Construction” sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit të gurit dekorativ.....                                                                                                                                       | 4313 |
| Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban, nr. 1956, datë 28.3.2017 | Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rrugët: “Sulejman Delvina”, “Medar Shtylla”, “Skënder Luarasi”, “Grigor Heba” dhe “Gjik Kuqali” Tiranë.....                                                                                                                            | 4316 |
| Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit<br>nr. 2021, datë 30.3.2017     | Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Urbanizim i zonës informale në lagjen “18 Tetori” Lushnjë.....                                                                                                                                                                                                                      | 4320 |
|                                                                    | Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ismail Dervishi. ....                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 4320 |

**VENDIM**

Nr. 245, datë 29.3.2017

**PËR DHËNIEN ME QIRA, ME  
TARIFË TË REDUKTUAR, TË SALLËS  
SË KONCERTEVE TË PALLATIT TË  
KONGRESEVE, TEATRIT KOMBËTAR  
TË OPERËS, BALETIT DHE  
ANSAMBLIT POPULLOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, dhe në vijim të pikës 8, të kreut III, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e dhënies me qira, me tarifë të reduktuar, të sallës së koncerteve të Pallatit të Kongreseve, Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor për zhvillimin e aktiviteteve të tij artistike deri në përfundim të rikonstruksionit të mjediseve të këtij teatri.

2. Tarifa e qirasë së sallës së koncerteve do të jetë në masën ekuivalente të shpenzimeve operative të kryera respektivisht për çdo aktivitet, gjatë gjithë periudhës së dhënies me qira.

3. Shpenzimet për pagesën e qirasë, sipas këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Kulturës.

4. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi**

**VENDIM**

Nr. 246, datë 29.3.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN  
NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E  
PERSONAVE TË SHPALLUR SI  
FINANCUES TË TERRORIZMIT”,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit, sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C” të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”, çregjistrohet individi i renditur në shkronjën “a” sipas ndryshimit, bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi**

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT

(“LISTA E OKB-së”)

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË  
OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN  
ISIL (Da’esh) dhe AL-QAIDA**



a) Lista e ndryshuar në **“Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”**;

1. FAHD; MUHAMMAD; 'ABD AL-'AZIZ; AL-KHASHIBAN

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

#### **VENDIM**

**Nr. 247, datë 29.3.2017**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI  
TË BASHKISË POGRADEÇ, NË  
NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË,  
TË PASURISË ME NR. 77, NË ZONËN  
KADASTRALE 2420, ME SIPËRFAQE 5  
900 m<sup>2</sup> DHE PËR NJË NDRYSHIM NË  
VENDIMIN NR. 417, DATË 8.6.2011, TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
MIRATIMIN E LISTËS  
PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË  
PALUAJTSHME PUBLIKE,  
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN  
NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË  
KOMUNËS ÇËRRAVË,  
TË QARKUT TË KORÇËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “e”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 417, datë 8.6.2011, të Këshillit të Ministrave, kudo, në titull dhe në përmbajtjen e vendimit, fjalët “...të Komunës Çërravë...” zëvendësohen me “...në njësinë administrative Çërravë, Bashkia Pogradec...”.

2. Transferimin në pronësi të Bashkisë Pogradec, në njësinë administrative Çërravë, të pasurisë me nr. 77, e ndodhur në zonën kadastrale 2420, me sipërfaqe 5 900 (pesë mijë e nëntëqind) m<sup>2</sup>, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim ndërtimin e stacionit të transferimit të mbetjeve të ngurta.

3. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 417, datë 8.6.2011, të Këshillit të Ministrave, të shtohet prona e përmendur në pikën 2.

4. Bashkisë Pogradec i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryetari i Bashkisë Pogradec dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**Niko Peleshi**


MIRATOHEIT  
KRYETARI BASHKISE



\$H\_{1.1}: 2500\$


POZICIONI NE PARTE I PASURISE.77

K-34-114-(103-D)



- Fronari Satul (ish N. B)
- Zona Kadastro. 2x20
- Nunni Psautir. 77
- Adresa Psihi Ieshnice.
- Nj. A. Çerrave Bashkia Pogradec.
- Vol. Page.
- Sipërfaqja. 6.1 ha.
- Indeksi Hartës, K-34.114-(103-D)
- Data 09.11.2016.
- Kategoria e Tokës. VIII-ë.
- Zonë Kadastrovë të dhe Pemtorë.

**PAMPE SATELLITORE & PRONES 77**



|                    |                   |
|--------------------|-------------------|
| Kufizmet e Pas: 77 | Sig. 6.1 ha       |
| Veri.....          | Pas nr - 81       |
| lindje.....        | Pas nr - 80, 122  |
| Jug.....           | Pas nr - 118, 122 |
| Pendim.....        | Pas nr - 118      |

SUPPLEMENTS:

Par. 77 ish me Sijërfare, 6.1 ka vjës e ish Ndërmarrës Bujëbëro

|                            |                              |                             |                              |                              |                             |
|----------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|------------------------------|-----------------------------|
| 1. X-47340.5<br>Y-452889.7 | 2. X-473979.1<br>Y-4522999.3 | 3. X-476146.9<br>Y-452536.2 | 4. X-476684.8<br>Y-4523376.8 | 5. X-475958.8<br>Y-4522919.9 | 6. X-475920.2<br>Y-452239.5 |
|----------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|------------------------------|-----------------------------|

FUND: GENERAL OSHAFF

**VENDIM****Nr. 250, datë 29.3.2017****PËR LIRIMIN, MANDATIMIN DHE  
RIMANDATIMIN E DISA ANËTARËVE  
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË  
KONTABILITETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lirimin nga funksioni, për shkak të përfundimit të mandatit, të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, si më poshtë vijon:

- z. Jorgji Bollano;
- znj. Flutura Kalemi;
- z. Limos Malaj.

2. Mandatimin, si anëtar të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të:

- znj. Ingrid Shuli, propozuar nga Instituti i Kontabilistëve të Miratuar;
- znj. Elona Mullahi, propozuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.

3. Rimandatimin si anëtar të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të z. Jorgji Bollano, propozuar nga Universiteti “Marin Barleti”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTRI****Niko Peleshi****VENDIM****Nr. 251, datë 29.3.2017****PËR DISA NDRYSHIME DHE  
SHTESA NË VENDIMIN NR. 7, DATË  
11.1.2017, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR PUNONJËSIT ME  
KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR  
VITIN 2017 NË NJËSITË E QEVERISJES  
QENDRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 7, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, të vendimit, numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme ndryshon dhe bëhet “...2 375 punonjës.”.

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1, të vendimit, bëhen këto shtesa:

a) Në ndarjet “Gr. 10, Ministria e Financave”, “Gr. 14, Ministria e Drejtësisë”, “Gr. 94, Ministria e Zhvillimit Urban”, dhe “Gr. 87, Institucione të tjera qeveritare”, shtohen nëndarjet përkatëse, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Pas ndarjes “Gr. 94, Ministria e Zhvillimit Urban”, shtohet ndarja “Gr. 95, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) Periudha kohore për emërtesën “operatorë”, në ndarjen “Gr. 14, Ministria e Drejtësisë”, bëhet 6-mujore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTRI****Niko Peleshi**



Tabela

| Gr. | Emri i Institucionit                                                | Nr. Punonjësve | Emërtesa            | Koha mesatare ditore | Periudhë kohore |
|-----|---------------------------------------------------------------------|----------------|---------------------|----------------------|-----------------|
| 10  | Ministria e Financave                                               | 1              |                     |                      |                 |
|     | <i>Drejtoria e Apelitit Tatimor</i>                                 | 1              | Punonjës Protokolli | 8 orë/ditë           | 6 muaj          |
| 14  | Ministria e Drejtësisë                                              | 1              |                     |                      |                 |
|     | <i>Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimit të Proves</i>               | 1              | Sanitar             | 6 orë/ditë           | mars-dhjetor    |
| 87  | Institucionet e tjera qeveritare                                    | 1              |                     |                      |                 |
|     | <i>Agjensia për Zhvillim Rajonal 3, Korçe</i>                       | 1              | Sanitar             | 6 orë/ditë           | mars-dhjetor    |
| 94  | Ministria e Zhvillimit Urban                                        | 100            |                     |                      |                 |
|     | <i>Drejtoritë Rajonale ALUIZNI</i>                                  | 80             | Specialistë         | 8 orë/ditë           | mars-dhjetor    |
|     | <i>Drejtoritë Rajonale ALUIZNI</i>                                  | 20             | Teknikë të mesëm    | 8 orë/ditë           | mars-dhjetor    |
| 95  | Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit | 2              |                     |                      |                 |
|     | <i>Aparatii institucionit</i>                                       | 1              | Sanitar             | 6 orë/ditë           | mars-dhjetor    |
|     | <i>Aparatii institucionit</i>                                       | 1              | Teknikë të mesëm    | 6 orë/ditë           | mars-dhjetor    |
|     | <b>TOTAL SHITESA PËR PUNONJËS ME KONTRATË</b>                       | <b>105</b>     |                     |                      |                 |

**VENDIM**

Nr. 259, datë 29.3.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 681, DATË 28.9.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “TIRANË–ELBASAN (RRËSHQITJA NË FSHATIN IBË)””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen

në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në tabelën bashkëlidhur vendimit nr. 681, datë 28.9.2016, të Këshillit të Ministrave, të dhënat e pronarit dhe të pasurisë në nënndarjen nr. 4 ndryshohen sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Niko Peleshi**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS**  
**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**  
**SEKTORI I SHPRONËSIMEVE**

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR  
 “TIRANË - ELBASAN (RRËSHQITJA NË FSHATIN IBË)”

| Nr. | PRONARI             | ZK   | Nr. pas. | Lloji i pasurisë | Sip. totale | Vlerësimet            |                              |              | Kultura bujqësore e drufrutorë | Vlera totale (lekë) | Shënime                |
|-----|---------------------|------|----------|------------------|-------------|-----------------------|------------------------------|--------------|--------------------------------|---------------------|------------------------|
|     | Emri i pronarit     |      |          |                  |             | Sip (m <sup>2</sup> ) | Çmimi (lekë/m <sup>2</sup> ) | Vlera (lekë) |                                |                     |                        |
| 4   | Osman Shaban Bunaca | 2735 | 22/14    | Arë              | 6500        | 248                   | 399                          | 98952        |                                | 98952               | Konfirmim nga ZVRPP-ja |

**VENDIM**

Nr. 260, datë 29.3.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË  
 VENDIMIN NR. 500, DATË 6.7.2010, TË  
 KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
 EMËRIMIN E KRYETARIT DHE TË  
 ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES  
 TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT  
 CIVIL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010, “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në pikën 1, të vendimit nr. 500, datë 6.7.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në numrat rendorë 1, 3 dhe 4, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

“Z. Bujar Tollkuçi, kryetar” zëvendësohet me “Z. Petrit Sulaj, kryetar”;

“Z. Engjëll Agaçi, anëtar” zëvendësohet me “Z. Sander Lleshi, anëtar”.

“Z. Krislen Keri, anëtar” zëvendësohet me “Z. Klajdi Mati, anëtar”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

**Niko Peleshi****VENDIM**

Nr. 261, datë 29.3.2017

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.  
 230, DATË 13.3.2015, TË KËSHILLIT TË  
 MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME  
 PAGESË TË QIRASË PËR DISA FAMILJE  
 QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT  
 “UNAZA E MADHE E TIRANËS”,  
 SEGMENTI “KOMUNA E PARISIT-  
 RRUGA E KAVAJËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 30 e 33, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 1, të vendimit nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf 1/1, si më poshtë:

“Subjektet e lidhjes 2, përfitojnë shtesë për periudhën e qirasë edhe një vit nga momenti i mbarimit të afatit.”.

2. Vlera shtesë për një vit e pagesës së qirasë për subjektet e listës emërore, sipas lidhjes 2, do të përballohet nga buxheti i vitit 2017 dhe 2018, i Ministrisë së Zhvillimit Urban.

3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Enti Kombëtar i Banesave dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

**Niko Peleshi**

**VENDIM**

Nr. 262, datë 29.3.2017

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA  
NË VENDIMIN NR. 661, DATË 8.10.2014,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES  
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE  
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,  
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I  
SEGMENTIT RRUGOR, “SKELE–UJI I  
FTOHTË, BASHKIA VLORE”,  
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “SKELE–UJI I FTOHTË”

(“ZONA II, SHKOLLA E MARINËS–UJI I FTOHTË”)

| Nr. | Pronari                                                                                        | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Sip. e prekur (truallit) (m <sup>2</sup> ) | Sipërfaqe ndërtimi | Çmimi i truallit, lekë | Çmimi i ndërtimit lekë/m <sup>2</sup> | Vlera lekë e truallit | Vlera e ndërtesës lekë | Vlera totale truall | Shënime                                       |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|----------------|--------------------------------------------|--------------------|------------------------|---------------------------------------|-----------------------|------------------------|---------------------|-----------------------------------------------|
| 4   | Alije Selmanaj<br>Bashkime Duka<br>Hiqmet Mici<br>Kenaqesi Gjini<br>Rahim Mici<br>Violeta Mici | 8602            | 77/5           | 1012.10                                    | 0                  | 10,174                 | 60,607                                | 10,297,105.40         | 0                      | 10,297,105.40       | Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, lloji “truall” |

**VENDIM**

Nr. 264, datë 29.3.2017

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK,  
TURIZMIT, TREGTISË DHE  
SIPËRMARRJES TE BASHKIA TIRANË,  
TË PASURISË ME NR. 2/377, VOL. 37,  
F. 133, ZK. 8380, ME EMËRTIM “GODINË  
NJËKATËSHE” E DHOMËS SË  
TREGTISË DHE INDUSTRIË TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 3, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike

të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Bashkia Tiranë, të pasurisë me nr. 2/377, vol.37, faqe 133, zona kadastrale 8380, me emërtim “Godinë njëkatëshe” e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 1 042 (një mijë e dyzet e dy) m<sup>2</sup>, nga të cilat 766 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimore dhe 276 (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) m<sup>2</sup> sipërfaqe truall funksional, me



vendndodhje në Rrugën e Kavajës, Tiranë, sipas dokumentacionit bashkëlidhur këtij vendimi, në funksion të ushtrimit të veprimtarive në fushën e përgjegjësisë së këtij institucioni, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Dhoma e Tregtisë dhe

Industrië Tiranë, Bashkia Tiranë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi

Miruar nga V. K. M. Nr. 319, Datë 7.11.1994

**KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME**

**A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE**

Zona Kadastrale: 8380 NR. I PASURISE : 2/377 Vol. 37 Fq. 133

Indeksi i Hartes: TR-O-11 Vijnë në: Vol. \_\_\_\_\_ Fq. \_\_\_\_\_ deri në: Vol. \_\_\_\_\_ Fq. \_\_\_\_\_

Adresa e Pasurisë: Rrethi TIRANË Q/ë TIRANË **PERFUNDIMTARE (data):** \_\_\_\_\_

Re/L KAJO KARAFILI P/G \_\_\_\_\_ SH \_\_\_\_\_ K \_\_\_\_\_ Ap \_\_\_\_\_

**B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE**

Lloji i Pasurisë: TRUALI Brenda V.K.N. : PO Ref PL. BREG

| Sip. Totale e Pasurisë                                    | Nga Sip. Totale: sa Trual                                 | Nga Sip. Trual: sa Ndërsesi                             |
|-----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------|
| 1. <u>1,042.00</u> m <sup>2</sup><br>Ref. <u>00013578</u> | 1. <u>1,042.00</u> m <sup>2</sup><br>Ref. <u>00013578</u> | 1. <u>766.00</u> m <sup>2</sup><br>Ref. <u>00013578</u> |
| 2. _____ m <sup>2</sup><br>Ref. _____                     | 2. _____ m <sup>2</sup><br>Ref. _____                     | 2. _____ m <sup>2</sup><br>Ref. _____                   |
| 3. _____ m <sup>2</sup><br>Ref. _____                     | 3. _____ m <sup>2</sup><br>Ref. _____                     | 3. _____ m <sup>2</sup><br>Ref. _____                   |
| 4. _____ m <sup>2</sup><br>Ref. _____                     | 4. _____ m <sup>2</sup><br>Ref. _____                     | 4. _____ m <sup>2</sup><br>Ref. _____                   |

Per njësien e përfaqësuar: PALLAT

Kuota e pjesëmarrjes: \_\_\_\_\_ %

Nr i Pasurise (pollat): \_\_\_\_\_

Vol. \_\_\_\_\_ Faqe \_\_\_\_\_

**C - SEKSIONI I PRONESISE**

| Nr. Dok  | Data Regjistrimit | Emri                  | Atësin | Mbiemri | Nr. Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Pagar | Data e Lësh. Certifikatës | Shënime             | Firma |
|----------|-------------------|-----------------------|--------|---------|-----------|-------|-------------------|---------------|---------------------------|---------------------|-------|
| 00013578 | 07.03.2014        | MINISTRIA E EKONOMISE |        |         |           | 1     | TIRANE            |               |                           | URDHER + PZ<br>RIL. |       |

Shënime: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqësues i familjes; B - bashkëpronar (\*a)



**D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA**

| Nr.Dok   | Data Regjistrimit | Tipi   | Përshkrimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Data e Lësh. Çertifikatës | Shënime | Firma                                                                               |
|----------|-------------------|--------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------|---------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| 00016247 | 20/02/2017        | B13_AV | BAZUAR VENDIMIT TE GJYKATES SE APELIT TIRANE ME NR 1366.DT 02 06 2015 I CILI NDRYSHON VENDIMIN NR 9744, DT 09 10 2014 TE GJ SJUK PARE TIRANE KU URDHEROHET FSHIRJA E TE DREJTAVE REALE TE KMSH TE FITUAR ME VENDIMIN NR 345,DT 24 09 2000 TE KKKP NE ZVRPP DITE REGJISTRIMIN E KETU VENDIMI NE FAVOR TE TARIKATIT ISLAMIK HALVETIAN. |                           |         |  |
|          |                   |        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                           |         |                                                                                     |

**E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj**

| Nr.Dok | Data<br>Regjistrimit | Tipi | Përshkrimi | Data e Lësh.<br>Certifikatës | Shënime | Firma |
|--------|----------------------|------|------------|------------------------------|---------|-------|
|        |                      |      |            |                              |         |       |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME  
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË  
Adresa: Rruga Jordan Nisija, Tiranë

TIRANË, më 23 / 2 / 2017

**SHËNIM:** Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone

Në regjistrin Vol 37, Faqe 133, Zona Kadastrale 8380, Qyteti Tiranë

REGISTRI  
LEDIANA EMBL

LEDIANA BRUNH



## HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT  
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME  
TIRANË

REGJISTRUES  
Lediana Bardhi



Vula e firmës

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË  
ZONA KADASTRALE 8380  
NR. I PASURISË: 2/372 VOL. 37 FQ. 133  
INDEKSI I HARTES: TR; 0-11 SHKALLA: 1:500  
ADRESA E PASURISË: Rrethi TIRANË Q/F TIRANË  
Rr/L: "KAZO KARAFLI" P/G      SH      K      Ap     


B. KUFIZIMET

C. PRONARI

V. 2/319; 2/196 MINISTRIA E EKONOMISË  
L. 2/413  
J. 2/102  
P. 2/327; 2/158; 2/340

D. Data: 23/02/2017





**VENDIM**

Nr. 265, datë 29.3.2017

**PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË  
SË 45.11% TË KUOTAVE TË SHOQËRISË  
“QENDRA TREGTARE E ZHVILLIMIT  
KULTUROR” SHPK, TIRANË, NGA  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË  
DHE SIPËRMARRJES TË  
BASHKIA E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Transferimin e pronësisë së 45.11% (dyzet e pesë pikë njëmbëdhjetë), të kuotave të shoqërisë “Qendra Tregtare e Zhvillimit Kulturor” sh.p.k., Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia e Tiranës.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi**

**VENDIM**

Nr. 266, datë 29.3.2017

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR  
LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË  
ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA,  
NDËRMJET MINISTRISË SË  
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,  
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI  
QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË  
“ROZAF” SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR  
PASURINË “OBJEKTE DHE TRUALL,  
TË AGJENCISË SË REZERVAVE  
MATERIALE TË SHTETIT LABINOT,  
ELBASAN (PJESA E MBETUR)”,  
TË MINISTRISË SË PUNËVE  
TË BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**


1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “Rozafa” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Objekte dhe truall, të Agjencisë së Rezervave Materiale të Shtetit Labinot, Elbasan (pjesa e mbetur)”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, Drejtorisë Rajonale të Rezervave të Shtetit Elbasan, me sipërfaqe të përgjithshme 52 514 (pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e katërmëdhjetë) m<sup>2</sup>, nga e cila 11 659.63 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tre) m<sup>2</sup> sipërfaqe e objekteve dhe 40 854.37 (dyzet mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër pikë tridhjetë e shtatë) m<sup>2</sup>, sipërfaqe funksionale, sipas genplanit dhe tekstit të kontratës bashkëlidhur këtij vendimi.



2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
ZYRA E NOTERISË TIRANË

Nr. \_\_\_\_\_ Rep.

Nr. \_\_\_\_\_ Kol.

KONTRATË QIRAJE  
Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata  
Lidhur

Në Tiranë, sot më datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2017, u paraqitën para meje noterit \_\_\_\_\_, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes**, përfaqësuar nga Z. \_\_\_\_\_, i datëlindjes \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.19\_\_\_\_, banues në \_\_\_\_\_, me shtetësi shqiptare i pajisur me letër njoftimin Nr. \_\_\_\_\_, që më poshtë do të quhet “QIRADHËNËSI”

DHE

**Shoqëria “ROZAFA” SHPK**, me seli qendrore në Shëngjin, Lezhë, dhe me adresë: Rruga: Luigj Gurakuqi, Tiranë, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga Q.K.B me NIPT: K48130547V, përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë Z. Gjergj Luca, i biri i Ndrekës, i datëlindjes 30.08.1964, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me shtetësi shqiptare, identifikuar me letër njoftimin personal me Nr. SA0253244, që më poshtë do të quhet “QIRAMARRËSI”.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me propozimin të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, mbështetur në vendimin Nr.54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.6756, datë 03.09.2015 i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, pas konkurrimit të zhvilluar në datën 7.03.2017, në zbatim të Urdhrit Nr. 1285, datë 16.02.2017 të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, shpalli fitues shoqërinë “ROZAFA” sh.p.k..

Në zbatim të vendimit Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2017 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 Euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si Qiradhënës dhe shoqërisë “ROZAFA” SHPK si Qiramarrës, për pasurinë “Objekte dhe truall, të Agjencisë së Rezervave Materiale të Shtetit Labinot, Elbasan (pjesa e mbetur)”, të Ministrisë së Punëve të Brendshme” dhe bazuar në nenet 801-825 të Kodit Civil, së bashku me "Qiramarrësin", palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

NENI 1  
OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira e pasurisë shtetërore: “Objekte dhe truall, të Agjencisë së Rezervave Materiale të Shtetit Labinot, Elbasan (pjesa e mbetur)” në përgjegjësi administrimi të të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave



të Shtetit, Drejtorisë Rajonale të Rezervave të Shtetit Elbasan (Vërtetimit nga dokumenti hipotekor i Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive Elbasan të lëshuar më datë 14.12.2016), me sipërfaqe të përgjithshme sipas genplanit 52 514 (pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e katërbëdhjetë) m<sup>2</sup>, nga ku sipërfaqe e objekteve është 11 659.63 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tre) m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe funksionale është 40 854.37 (dyzetmijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër pikë tridhjetë e shtatë) m<sup>2</sup>.

## **NENI 2**

### **QËLLIMI I PËRDORIMIT**

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për prodhimin e produkteve të detit të përpunuara, nëpërmjet përpunimit aktiv të mallrave, sipas autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## **NENI 3**

### **KOHËZGJATJA**

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 (njëzetë) vjet dhe hyn në fuqi me firmosjen e saj nga palët.

## **NENI 4**

### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT**

**4.1** “Qiradhënësi”, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, si njësi që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t’u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet proces-verbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

**4.2** “Qiradhënësi” ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e “Qiramarrësit”.

**4.3** “Qiradhënësi” është i detyruar të garantojë “Qiramarrësin” për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

**4.4** “Qiradhënësi” ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 60 ditë përpara me shkrim.

**4.5** “Qiradhënësi” nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

## **NENI 5**

### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT**

**5.1** “Qiramarrësi” ka të drejtë që sipas legjislacionit në fuqi të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.



**5.2** “Qiramarrësi” ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga Legjislacioni Shqiptar për Mjedisin dhe Konventat Ndërkombëtare për mjedisin në të cilat aderon Republika e Shqipërisë.

**5.3** “Qiramarrësi” ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2.

**5.4** “Qiramarrësi” detyrohet që për zhvillimin e aktivitetit, të jetë i pajisur me Autorizimin për përpunim aktiv të mallrave, lëshuar prej institucioneve shtetërore, aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Një kopje e autorizimit, si dhe gjithmonë kur ai përsëritet, duhet të paraqitet edhe tek Qiradhënësi.

**5.5** “Qiramarrësi” detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në plan biznesin e paraqitur në konkurrim.

**5.6** “Qiramarrësi”, në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, do të investojë, si punime ndërtimore për rikonstruksion dhe ndërtim të godinave e ambienteve të tjera, blerje dhe vendosje linja e makineri, në vlerën totale prej 127 554 194 ( me TVSH) (njëqind e njëzet e shtatë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e katërmijë e njëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë, sipas parashikimit për investimet dhe fazat e zhvillimit të tij, të shprehura në plan-biznesin e paraqitur në konkurrim, që janë si vijon:

Faza e parë: Me një investim prej 30 089 089 lekë, brenda vitit 2018 do të realizohet. Ky investim parashikon ndërtimin e fabrikës për përpunimin e fshikëzës notuese të merlucit të Atlantikut. Investimi do të konsistojë në ndërtimin e njësisë prodhuese dhe të mjediseve në funksion të saj si shërbime higjienike, gardëroba, mensa e punëtoreve etj.

Faza e dytë: Me një investim prej 97 465 105.496 lekë, brenda vitit 2019 do të realizohet ndërtimi i fabrikës për prodhimin e filetove të peshkut dhe peshkut panato, si dhe fabrikës për prodhimin e miellit të peshkut. Investimi do të konsistojë në ndërtimin e njësisë prodhuese dhe të mjediseve në funksion të saj si shërbime higjienike, gardëroba, mensa e punëtoreve etj. Investimi do të konsistojë në përgatitjen e kaponit për vendosjen e makinerive dhe makineritë për bluarjen, trajtimin me avull, tharjen e peshkut.

Investimet përfshijnë edhe rikonstruksionin e kaponëve për frigoriferë/konxhelator, krijimin e faciliteteve ruajtëse dhe magazinuese të lëndës së parë, investime në infrastrukturën ndihmëse, sistemim i territorit dhe rrugët lidhëse midis kaponëve, sistemimi i kanalizimeve dhe furnizimi me ujë.

**5.7** “Qiramarrësi”, sipas parashikimit për punësimin të shprehur në plan-biznesin e paraqitur në konkurrim, detyrohet që, në objektin e marrë me qira, në fund të fund të vitit 2018 do të ketë të punësuar 45 (dyzet e pesë) punonjës dhe në fazën e dytë, në fund të vitit 2019 do të ketë të punësuar edhe 85 (tetëdhjetë e pesë) punonjës të rinj. Pra, në përfundim të investimit në fund të vitit 2019, “Qiramarrësi” do të ketë të punësuar 130 (njëqind e tridhjetë) punonjës.

**5.8** “Qiramarrësi” detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira sipas kësaj kontrate, të paraqesë para Qiradhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.6 dhe 5.7 të kësaj kontrate.



**5.9** “Qiramarrësi” detyrohet të paraqesë tek “Qiradhënësi” në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

**5.10** “Qiramarrësi” detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

**5.11** “Qiramarrësi”, në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. “Qiradhënësi” nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga “Qiramarrësi”.

**5.12** Në ngarkim të “Qiramarrësit” janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

**5.13** “Qiramarrësi”, në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit sipas nenit 2 të kësaj kontrate, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.6 dhe 5.7, detyrohet që, të pajiset me Lejet ose Autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

## NENI 6 PAGESA E QIRASË

**6.1** “Qiramarrësi” detyrohet t’i paguajë “Qiradhënësit” detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) Euro. Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata.

**6.2** Para nënshkrimit të kontratës “Qiramarrësi” ka paguar garancinë e kontratës, në vlerën 2 551 084 (dy milionë e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e tetëdhjetë e katër) Lekë, sipas faturës së lëshuar nga “Qiradhënësi”, e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.6 të kësaj kontrate.

**6.3** Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete (gjoba dhe kamatvonesa), “Qiramarrësi” do të likuadojë vlerat e krijuara në llogarinë e “Qiradhënësit” sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

## NENI 7 PENALITETET

**7.1** Në rastin kur “Qiramarrësi”, në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar investimet e përcaktuara në pikën 5.6, të kësaj kontrate, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, “Qiradhënësi” zgjidh kontratën dhe gjobit “Qiramarrësin” me vlerën e garancisë së ngurtësuar në atë moment.

**7.2** Në rastin kur, “Qiramarrësi”, në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.7, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për çdo vend pune të pahapur.



## NENI 8 ZGJIDHJA E KONTRATËS

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

- a. në marrëveshje midis palëve.
- b. kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore.
- c. kur “Qiramarrësi” shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate.
- d. kur “Qiramarrësi” nuk pajiset me autorizim për përpunimin aktiv të mallrave, ose rifreskimin e tij, për një periudhë mbi 5 (pesë) muaj.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 60 ditë pas njoftimit me shkrim të “Qiradhënësit” për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse “Qiramarrësi” nuk ka reaguar me shkrim.

## NENI 9 PËRGJEGJËSITË E PALËVE

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të çdo faze për investimin, pas relacionit të paraqitur nga “Qiramarrësi”, sipas pikave 5.6 dhe 5.7 të kësaj kontrate, palët janë të detyruar të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit dhe “Qiramarrësit”, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël.

9.3 Palët, “Qiramarrësi” dhe Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave të Shtetit janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me “Forcë Madhore” do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 “Qiramarrësi” përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhimit të Forcës Madhore dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

## NENI 10 DISPOZITAT E FUNDIT

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t’i referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë Plan biznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe proces verbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.



**10.3** Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### NENI 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi ju lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter \_\_\_\_\_, në bazë të nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

#### QIRADHËNËSI

Ministria e Zhvillimit Ekonomik,  
Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes  
Përfaqësuar nga

#### QIRAMARRËSI

Shoqëria “ROZAFa” sh.p.k.

Përfaqësuar nga

Gjergj Luca

#### VENDIM

Nr. 269, datë 29.3.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE  
TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË  
KRITERET E PRANIMIT NË NJË  
PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË  
STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË  
INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË  
NJË PROGRAM TË STUDIMEVE  
PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHN  
NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të neneve 1 dhe 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të neneve 2 dhe 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të neneve 1 dhe 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të

Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, dhe të neneve 5 dhe 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore””, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Përfashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët të cilët janë pranuar në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, në institucionet publike të arsimit të lartë, të kategorive të mëposhtme:

a) Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë,



familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

b) Studentët, familjet e të cilëve trajtohen /përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, si dhe studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;

c) Studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;

ç) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;

d) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore;

dh) Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe ajo e mbrojtjes;

e) Studentët romë dhe ballkano-egjiptianët, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale;

ë) Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;

f) Studentët e shkëlqyer që rezultojnë me notën mesatare vjetore 10 (dhjetë), për studentët e regjistruar në vitet pas të parit, notë mesatare maksimale do të konsiderohet nota 10 (dhjetë), e përlogaritur si mesatare e notave të të gjitha provimeve/detyrimeve të shlyera dhe të parashikuara për programin përkatës të studimit për vitet pararendëse. Këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës;

g) Studentët e shkëlqyer, me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që ndjekin studimet në një program studimi të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë. Notë mesatare maksimale do të konsiderohet nota 10 (dhjetë) e përlogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë dhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve të shkëlqyer hartohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe dërgohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit si dhe në institucionet publike të arsimit të lartë.

2. Studentët sipas kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1 të këtij vendimi, përjashtohen nga tarifa vjetore e studimit, pas paraqitjes së dokumentacionit vërtetues për statusin e tyre ligjor, me vendim të Bordit të Administrimit të Institucionit Publik të Arsimit të Lartë.

Bordi i Administrimit të institucionit shqyrton dhe miraton për çdo vit akademik, jo më vonë se muaji dhjetor, listën e studentëve të kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1, të këtij vendimi. Për vitin akademik 2016-2017, ky vendim duhet të realizohet brenda muajit prill 2017. Vendimi i Bordit të Administrimit të Institucionit Publik të Arsimit të Lartë i njoftohet Agjencisë Kombëtare së Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit.

3. Individët që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtit cikël. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.

4. Studentit përsëritës i ndërpritet mbështetja nga fondet publike, me përjashtim të rasteve të forcave madhore.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes si dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**

**VENDIM****Nr. 271, datë 29.3.2017**

**PËR LËVIZJEN JASHTË TERRITORIT  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË 18  
VEPRAVE TË ARTIT NË PIKTURË DHE  
VIZATIM, PJSË E FONDIT TË  
GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE,  
ME QËLLIM REALIZIMIN E  
EKSPOZITAVE “DOCUMENTA 14”, QË  
DO TË ZHVILLOHEN NË AMBIENTET  
E MUZEUT KOMBËTAR TË ARTIT  
BASHKËKOHOR ATHINË, GREQI, DHE  
NË MUZEUN E ARTEVE TË BUKURA,  
NEUE GALERIE, KASSEL, GJERMANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 15 (pesëmbëdhjetë) veprave të artit në pikturë dhe vizatim, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, me qëllim realizimin e ekspozitës që do të zhvillohet në ambientet e Muzeut Kombëtar të Artit Bashkëkohor, Athinë, Greqi, sipas tabelës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 3 (tri) veprave të artit në pikturë dhe vizatim, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, me qëllim realizimin e

ekspozitës që do të zhvillohet në ambientet e Muzeut të Arteve të Bukura, *Neue Galerie*, Kassel Gjermani, sipas tabelës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Lejimi i lëvizjes të bëhet nga data 31 mars 2017 deri më 6 gusht 2017, për veprat e artit, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Artit, që kërkohen të ekspozohen në Muzeun e Artit Bashkëkohor Athinë, Greqi.

4. Lejimi i lëvizjes të bëhet nga data 2 maj 2017 deri më 8 tetor 2017, për veprat e artit, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Artit, që kërkohen të ekspozohen në Muzeun e Arteve të Bukura, *Neue Galerie*, Kassel, Gjermani.

5. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e lëvizjes së objekteve të trashëgimisë kulturore, të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

6. Ngarkohet Galeria Kombëtare e Arteve të kryejë shoqërimin dhe kthimin e veprave në vendin e origjinës, pas mbarimit të veprimtarisë, dhe Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.

7. Ngarkohet ministri i Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI****Niko Peleshi**



TABELA I  
LISTA E VEPRAVE TË EKSPOZITËS “DOKUMENTA 14” NË ATHINË

| Nr. | Nr. i inv. | Emri i autorit    | Titulli i veprës              | Përmasat       | Teknika | Materiali | Viti        | Çmimi në ALL |
|-----|------------|-------------------|-------------------------------|----------------|---------|-----------|-------------|--------------|
| 1   | 50         | Kel Kodheli       | Emrushë (Arapë)               | 70 x 56 cm     | Vaj     | Kompesatë | 1944 – 1945 | 350.000      |
| 2   | 165        | Androniqi Antoniu | Autoportret                   | 32 x 43.5 cm   | Vaj     | Beze      | 1935        | 150.000      |
| 3   | 461        | Abdurrahim Buza   | Refugjatët                    | 50 x 41 cm     | Vaj     | Kanavacë  | 1957        | 500.000      |
| 4   | 485        | Abdurrahim Buza   | Autoportret                   | 41.5 x 30.5 cm | Vaj     | Kompesatë | 1934        | 500.000      |
| 5   | 748        | Hasan Nallbani    | Me shatë në krah              | 90 x 70 cm     | Vaj     | Kanavacë  | 1966        | 150.000      |
| 6   | 765        | Spiro Kristo      | Fëmijët                       | 195 x 200.5 cm | Vaj     | Kanavacë  | 1966        | 150.000      |
| 7   | 902        | Sotir Capo        | Prodhuesja e telave elektrike | 120 x 93 cm    | Vaj     | Kanavacë  | 1969        | 150.000      |
| 8   | 905        | Zef Shoshi        | Tornitorja                    | 120 x 85 cm    | Vaj     | Kanavacë  | 1969        | 250.000      |
| 9   | 1166       | Llambi Blido      | Në pulin e komandimit         | 118 x 129 cm   | Vaj     | Kanavacë  | 1971        | 150.000      |
| 10  | 1231       | Arben Basha       | Unë do të shkruaj             | 102 x 139.5 cm | Vaj     | Kanavacë  | 1971        | 150.000      |
| 11  | 1828       | Spiro Kristo      | Brigadierja                   | 110 x 130 cm   | Vaj     | Kanavacë  | 1976        | 100.000      |
| 12  | 1924       | Pandi Mele        | Ushtarë të revolucionit       | 124 x 100 cm   | Vaj     | Kanavacë  | 1968        | 150.000      |
| 13  | 2058       | Gani Strazimiri   | Pazari i vjetër i Tiranës     | 64 x 99 cm     | Vaj     | Kompesatë | 1936        | 200.000      |
| 14  | 3538       | Foto Stamo        | Refugjatët (2)                | 31 x 47 cm     | Vaj     | Kompesatë | 1941        | 200.000      |
| 15  | 1307       | Edi Hila          | Mbjellja e pemëve             | 150 x 199 cm   | Vaj     | Kanavacë  | 1971        | 350.000      |

TABELA II  
LISTA E VEPRAVE TË EKSPOZITËS “DOKUMENTA 14” NË KASSEL

| Nr. | Nr. i inv. | Emri i autorit    | Titulli i veprës         | Përmasat   | Teknika | Materiali | Viti | Çmimi në lekë |
|-----|------------|-------------------|--------------------------|------------|---------|-----------|------|---------------|
| 1   | 2759       | Androniqi Antoniu | Në kopshtin e fëmijëve   | 32 x 24 cm | Laps    | Letër     | 1948 | 50.000        |
| 2   | 2761       | Androniqi Antoniu | Në Pazarin e Krujës      | 28 x 33 cm | Laps    | Letër     | 1938 | 100.000       |
| 3   | 3585       | Hasan Reçi        | Cikël për 4 shkurtin (6) | 26 x 19 cm | Laps    | Letër     | -    | 80.000        |

### VENDIM

Nr. 274, datë 29.3.2017

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR  
DHE KULLOSOR PUBLIK DHE  
PAKËSIMIN NË VOLUM TË  
SIPËRFAQES PREJ 21.56 HA, NË  
OBJEKTIN “HOTOLISHT”, BASHKIA  
LIBRAZHD, QË DO TË PËRDORET  
NGA SHOQËRIA “ROSI  
CONSTRUCTION” SHPK PËR  
SHFRYTËZIMIN E MINERALIT TË  
GURIT DEKORATIV**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

### VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 21.56 ha, në objektin “Hotolisht”, që do të përdoret nga shoqëria “Rosi Construction” sh.p.k. për shfrytëzimin e mineralit të gurit dekorativ, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullor publik i Bashkisë Librazhd, të pakësohet në volum dhe çregjistrohet nga Regjistri i Kadastrës së Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për sipërfaqet pyjore që pakësohen në volum dhe hiqen nga fondi pyjor e kullor publik, dhe harta topografike, me koordinatat e poligonit të sipërfaqes objekt mineralar, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit në volum të lëndës drusore, produkteve të tjera pyjore e kullorore dhe të investimeve të kryera në vite, objekt i këtij vendimi, paguhet nga shoqëria



“Rosi Construction” sh.p.k., në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar, dhe derdhen në llogarinë bankare të Bashkisë Librazhd.

3. Shoqëria “Rosi Construction” sh.p.k., brenda pesë viteve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes me Bashkinë Librazhd, të pyllëzojë me fondet e veta, me drurë pyjorë, një sipërfaqe prej 14 ha.

4. Bashkia Librazhd dhe shoqëria “Rosi Construction” sh.p.k. nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Një kopje e marrëveshjes, së bashku me projektet e miratuara, dërgohet për monitorim në Ministrinë e Mjedisit, jo më vonë se 10 ditë nga data e nënshkrimit të saj.

5. Sipërfaqet pyjore sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën regjistrimin e sipërfaqes pyjore të identifikuar sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt i aktivitetit mineral të shfrytëzimit të gurit dekorativ”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit, sipas lejes mjedisore, nga shoqëria “Rosi Construction” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullësor publik të Bashkisë Librazhd.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Librazhd dhe Shoqëria “Rosi Construction” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Niko Peleshi

### Bashkia Librazhd


#### LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK

#### QË HIQEN PËR SHFRYTËZIMIN E GURIT DEKORATIV NGA SUBJEKTI "ROSI CONSTRUCTION" shpk

| Nr.             | ID pones    | Ekonomia pyjore/Kullësore | Ng/n/gast. | Sipërfaqja qe hiqet nga fondi pyjor/kullësor ha |
|-----------------|-------------|---------------------------|------------|-------------------------------------------------|
| 1               | 2           | 3                         | 4          | 5                                               |
| 1               | EL32 00 115 | Librazhd                  | 115a       | 7.29                                            |
| 2               | EL32 00 116 | Librazhd                  | 116a       | 1.78                                            |
| 3               | EL65 00 003 | Vehcan                    | 3a         | 4.52                                            |
| 4               | EL65 00 003 | Vehcan                    | 3b         | 3.81                                            |
| 5               | EL65 00 004 | Vehcan                    | 4b         | 4.16                                            |
| <b>GJITHSEJ</b> |             |                           |            | <b>21.56</b>                                    |



Planimetria e sipërfaqes së kërkuar nga Firma "Rosi Construction" me administrator Robert Sinani dhe e miratuar në lejen e shfrytëzimit nr.1204, datë 02.07.2008, Objekti Hotolisht, Njësia Administrative Hotolisht dhe fshati Dragostunje, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd, si dhe planimetria e parcelave pyjore pasqyruar në hartën topografike të shkallës 1:25 000 e gjeoreferuar, dhe printuar në shkallën 1:10 000.



**KËRKESË****Nr. 1956, datë 28.3.2017****PËR SHPRONËSIM  
PËR INTERES PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rrugët: “Sulejman Delvina”, “Medar Shtylla”, “Skënder Luarasi”, “Grigor Heba” dhe “Gjik Kuqali” Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim,

që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” të ndryshuar, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është **115,185,048 (njëqind e pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyzet e tetë) lekë.**

ZËVENDËSMINISTRI I  
ZHVILLIMIT URBAN  
**Alfred Dalipi**



BASHKIA  
TIRANË

### DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE E ASETEVE DHE LIÇENSIMIT

Logarifitet paraprake për pasuritë që preken nga projekti për "Rikualifikim Urban i Bllokut të kufizuar nga rr. "Sulejman Delvina", "Skënder Shtylla", "Medar Shtylla", "Grigor Heba", "Gjik Kuqall" (Faza e Parë)

| Nr | EMËR ATËSIA MBIEMËR                                                                                                                                               | Z. K. | NR. Pas. | SIP. Përgj. Truall m <sup>2</sup> | SIP. Prekur Truall m <sup>2</sup> | Çmimi për Truall lekë/m <sup>2</sup> | Objekti sip. Përgj. m <sup>2</sup> | Objekti sipfaqja preket m <sup>2</sup> | Çmimi për Objekt lekë/m <sup>2</sup> | VLERA (objekt i prekur) lekë | VLERA (truall + objekt) lekë | KONFIRMIM ZVRPP, TIRANË                                     |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|----------|-----------------------------------|-----------------------------------|--------------------------------------|------------------------------------|----------------------------------------|--------------------------------------|------------------------------|------------------------------|-------------------------------------------------------------|
| 1  | Bashkëpronarët Kika, Pleshti, Verzivoli                                                                                                                           | 8260  | 6/340    | 1045                              | 403                               | 30783                                |                                    |                                        | 12405549                             | 0                            | 12405549                     | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 2  | Shtet                                                                                                                                                             | 8260  | 6/67     | 50.35                             | 29                                | 30783                                |                                    |                                        | 0                                    | 0                            | 0                            | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 3  | Shtet                                                                                                                                                             | 8260  | 6/537    | 284.3                             | 134                               | 30783                                |                                    |                                        | 0                                    | 0                            | 0                            | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 4  | Bashkëpronarët, Papa, Buda, Xheka, Stasoli, Kostandini, Kumani, Kisi, Tona, Panajoti, Kasimati, Gero, Basto, Leka, Kristuli, Beje, Jançe, Tiço, Poda, Priti, Tasi | 8260  | 4/430    | 737                               | 90                                | 30783                                |                                    |                                        | 2770470                              | 0                            | 2770470                      | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 5  | Shtet                                                                                                                                                             | 8260  | 6/517    | 2618.18                           | 990                               | 30783                                |                                    |                                        | 0                                    | 0                            | 0                            | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 6  | Bashkëpronarët Gama, Pihari, Kalemli, Kukaleshi, Kusi, Kristani                                                                                                   | 8260  | 6/282    | 416                               | 416                               | 30783                                |                                    |                                        | 12805728                             | 0                            | 12805728                     | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 7  | Shtet                                                                                                                                                             | 8260  | 6/641    | 1171.09                           | 3.6                               | 30783                                |                                    |                                        | 0                                    | 0                            | 0                            | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 8  | Shtet                                                                                                                                                             | 8260  | 6/68     | 127.47                            | 127.47                            | 30783                                |                                    |                                        | 0                                    | 0                            | 0                            | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 9  | Fatmira Sinani                                                                                                                                                    | 8260  | 6/68/ND  | 0                                 | 0                                 | 0                                    | 127                                | 127                                    | 103254                               | 13113258                     | 13113258                     | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/3 datë 30.06.2016 |
| 10 | Erion Shtilian Thomai                                                                                                                                             | 8260  | 6/283    | 600                               | 91                                | 30783                                |                                    |                                        | 2801253                              | 0                            | 2801253                      | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 11 | "Haxhiu"shpk                                                                                                                                                      | 8260  | 6/675    | 3114                              | 0                                 | 0                                    |                                    |                                        | 0                                    | 0                            | 0                            | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 12 | "Haxhiu"shpk                                                                                                                                                      | 8260  | 6/676    | 1872                              | 0                                 | 0                                    |                                    |                                        | 0                                    | 0                            | 0                            | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 13 | Bashkëpronarët Kika, Vorpsi, Pleshti, Verzivoli                                                                                                                   | 8260  | 6/344    | 420                               | 353                               | 30783                                |                                    |                                        | 10854086                             | 0                            | 10854086                     | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 14 | Flutura Qazim Verzivoli                                                                                                                                           | 8260  | 6/354    | 662                               | 129                               | 30783                                |                                    |                                        | 3971007                              | 0                            | 3971007                      | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 15 | Shtet                                                                                                                                                             | 8270  | 6/458    | 60                                | 40                                | 66969                                |                                    |                                        | 0                                    | 0                            | 0                            | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 16 | Mynvera Neim Spaho                                                                                                                                                | 8270  | 6/102    | 640                               | 61                                | 66969                                |                                    |                                        | 4085109                              | 0                            | 4085109                      | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 17 | Shtet                                                                                                                                                             | 8270  | 6/2      | 503                               | 281                               | 66969                                |                                    |                                        | 0                                    | 0                            | 0                            | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |



|    |                                                                                                                                                                                |      |          |        |      |       |  |  |  |  |  |          |         |          |         |          |         |          |                                                             |
|----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|----------|--------|------|-------|--|--|--|--|--|----------|---------|----------|---------|----------|---------|----------|-------------------------------------------------------------|
| 18 | Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati               | 8270 | 6/356    | 380    | 127  | 66969 |  |  |  |  |  |          | 8511760 | 0        | 8511760 | 0        | 8511760 | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 19 | Bashkëpronarët Kasmi                                                                                                                                                           | 8270 | 6/233    | 69     | 0    | 0     |  |  |  |  |  |          | 0       | 0        | 0       | 0        | 0       | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 20 | Shtet                                                                                                                                                                          | 8270 | 6/443    | 141    | 52.5 | 66969 |  |  |  |  |  |          | 0       | 0        | 0       | 0        | 0       | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 21 | Shtet                                                                                                                                                                          | 8260 | 4/118    | 1421   | 1376 | 30783 |  |  |  |  |  |          | 0       | 0        | 0       | 0        | 0       | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 22 | Shtet                                                                                                                                                                          | 8270 | 6/116    | 87     | 31.5 | 66969 |  |  |  |  |  |          | 0       | 0        | 0       | 0        | 0       | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 23 | Shtet                                                                                                                                                                          | 8270 | 8/648    | 384    | 12.5 | 66969 |  |  |  |  |  |          | 0       | 0        | 0       | 0        | 0       | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 24 | Bahri Osman Pinari                                                                                                                                                             | 8270 | 6/318    | 140    | 3.5  | 66969 |  |  |  |  |  |          | 234392  | 0        | 234392  | 0        | 234392  | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 25 | Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati               | 8260 | 4/437    | 107.2  | 7    | 30783 |  |  |  |  |  |          | 215481  | 0        | 215481  | 0        | 215481  | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 26 | Mynevere Neim Spaho                                                                                                                                                            | 8260 | 4/113    | 390    | 162  | 30783 |  |  |  |  |  |          | 4986846 | 0        | 4986846 | 0        | 4986846 | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 27 | Bashkëpronarët Dimitresku e Santo                                                                                                                                              | 8260 | 4/111    | 124    | 18   | 30783 |  |  |  |  |  |          | 554094  | 0        | 554094  | 0        | 554094  | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 28 | Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati               | 8260 | 4/435    | 379.5  | 92   | 30783 |  |  |  |  |  |          | 2832036 | 0        | 2832036 | 0        | 2832036 | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 29 | Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati               | 8260 | 4/436    | 317.8  | 148  | 30783 |  |  |  |  |  |          | 4555884 | 0        | 4555884 | 0        | 4555884 | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 30 | Bashkëpronarët Kisi, Guga, Kumani, Jançe, Tona, Tase, Pambuku, Sapiqoti, Panajoti, Kasimati, Gero, Leka, Basko, Spaho, Kristuli, Bele                                          | 8260 | 4/394    | 90     | 47   | 30783 |  |  |  |  |  |          | 1446801 | 0        | 1446801 | 0        | 1446801 | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 31 | Shtet                                                                                                                                                                          | 8260 | 4/610    | 232.86 | 212  | 30783 |  |  |  |  |  |          | 0       | 0        | 0       | 0        | 0       | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 32 | Shtet                                                                                                                                                                          | 8260 | 4/253    | 588.65 | 564  | 30783 |  |  |  |  |  |          | 0       | 0        | 0       | 0        | 0       | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 33 | Nezir Alla                                                                                                                                                                     | 8260 | 4/253/ND |        | 0    | 0     |  |  |  |  |  | 67749.74 | 0       | 11361631 | 0       | 11361631 | 0       | 11361631 | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/3 datë 30.06.2016 |
| 34 | Ardian Dashi                                                                                                                                                                   | 8260 | 4/251/ND |        | 0    | 0     |  |  |  |  |  | 94.4     | 103254  | 0        | 9747178 | 0        | 9747178 | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/3 datë 30.06.2016 |
| 35 | Bashkëpronarët Kisi, Guga, Kumani, Jançe, Tona, Pirfti, Tase, Vodo, Sapiqoti, Panajoti, Kasimati, Gero, Leka, Basko, Kristuli, Bele, Papa, Buda, Derishi, Tiço, Xheka, Stasoli | 8260 | 4/387    | 175    | 34   | 30783 |  |  |  |  |  |          | 1046622 | 0        | 1046622 | 0        | 1046622 | 0        | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |



|       |                                                                                                                                                                               |      |       |        |         |       |  |  |       |  |  |            |          |           |                                                             |
|-------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|-------|--------|---------|-------|--|--|-------|--|--|------------|----------|-----------|-------------------------------------------------------------|
| 36    | Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati              | 8260 | 4/444 | 149    | 29      | 30783 |  |  |       |  |  | 892707     | 0        | 892707    | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 37    | Bashkëpronarët Kisi, Guga, Kumani, Jançe, Tona, Priti, Tase, Vodo, Sopiçoti, Panajoti, Kasimati, Gero, Leka, Basko, Kristuli, Bele, Papa, Buda, Derishi, Tiço, Xheka, Stasoli | 8260 | 4/386 | 140    | 10      | 30783 |  |  |       |  |  | 307830     | 0        | 307830    | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 38    | Bashkëpronarët Kisi, Guga, Kumani, Jançe, Tona, Priti, Tase, Vodo, Sopiçoti, Panajoti, Kasimati, Gero, Leka, Basko, Kristuli, Bele, Papa, Buda, Derishi, Tiço, Xheka, Stasoli | 8260 | 4/388 | 130    | 10      | 30783 |  |  |       |  |  | 307830     | 0        | 307830    | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 39    | Frensis Shkëlqim Spaho, Elvana Stefan Spaho                                                                                                                                   | 8260 | 4/540 | 598.02 | 5       | 30783 |  |  |       |  |  | 153915     | 0        | 153915    | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 40    | Shtet                                                                                                                                                                         | 8260 | 4/254 | 109.4  | 105     | 30783 |  |  |       |  |  | 0          | 0        | 0         | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 41    | Pasuria e pozicionuar në hartë ndërmjet pas. nr. 6/233 zk. 8270 dhe pas. nr. 6/469 zk. 8270                                                                                   | 8270 |       |        | 20      | 66969 |  |  |       |  |  | 1339380    | 0        | 1339380   | në shkresën e ZVRPP - është shënim pa informacion           |
| 42    | Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati              | 8270 | 6/360 | 599    | 33      | 66969 |  |  |       |  |  | 2209977    | 0        | 2209977   | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 43    | Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati              | 8270 | 6/358 | 83.4   | 17      | 66969 |  |  |       |  |  | 1138473    | 0        | 1138473   | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 44    | Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati              | 8270 | 6/357 | 33.6   | 8       | 66969 |  |  |       |  |  | 535752     | 0        | 535752    | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| 45    | Shtet                                                                                                                                                                         | 8270 | 6/441 | 216    | 187     | 66969 |  |  |       |  |  | 0          | 0        | 0         | Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016 |
| SHUMA |                                                                                                                                                                               |      |       |        | 6458.77 |       |  |  | 389.1 |  |  | 80962981.2 | 34222067 | 115185048 |                                                             |

## SHËNIMI:

- Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt 03.02.2016.
- Për objektet çmimi për llogaritje është marrë nga Udhëzimi Nr.4 datë 30.09.2015 "për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, për vitin 2015" dhe shkresës së ZVRPP Tiranë nr. prot. 30329/3, datë 12.01.2017
- Pasuritë e prekura nga projekti. Konfirmohen nga ZVRPP, Tiranë, me shkresat nr. prot. 5034/1, datë 11.03.2016 dhe nr. prot. 5034/3, datë 30.06.2016
- Pasuria e pozicionuar në hartë ndërmjet pas. nr. 6/233 zk. 8270 dhe pas. nr. 6/469 zk. 8270 në fragmentin e hartës që shfaqon shkresën nr. prot. 5034/1, datë 11.03.2016 të ZVRPP Tiranë ka shënimin pa informacion.
- Pasuritë me nr. 6/233 zk. 8260, nr. 6/675 zk. 8260, nr. 6/676 zk. 8260 janë menaxhuar me leje ndërtimi

**KËRKESË****Nr. 2021, datë 30.3.2017****PËR SHPRONËSIM  
PËR INTERES PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Urbanizim i zonës informale në lagjen “18 Tetori” Lushnjë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në

bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” të ndryshuar, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është **630,362 (gjashtëqind e tridhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë.**

**ZËVENDESMINISTRI  
I ZHVILLIMIT URBAN  
Alfred Dalipi**

**Vlera e shpronësimit e truallit të z.Lumturi Ali Manlli + bashkpronare dhe z.Xhevair Beqir Lika  
Si pasojë e investimit "Urbanizimi I zones informale ne lagjen 18 Tetori"**

**Ne lagjen 18 tetori Zona kadastrale 8572**

**INVESTITORI : BASHKIA LUSHNJE**

| Nr | N/ pasuris | Emri Mbiemri                 | Zona kadastrale | Lloji i pronës | Njesia | Sasia               | Çmimi | Vlera         |
|----|------------|------------------------------|-----------------|----------------|--------|---------------------|-------|---------------|
| 1  | 25/136     | Lumturi Manlli +bashkpronare | 8572            | Truall         | m2     | 51.7                | 8954  | 462922        |
| 2  | 20/177     | Xhevair Beqir Lika           | 8572            | Truall         | m2     | 18.7                | 8954  | 167440        |
|    |            |                              |                 |                |        | <b>Shuma totale</b> |       | <b>630362</b> |

**VENDIM**

*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1125, datë 17.2.2017, vendosi shpalljen e

zhdukjes së shtetasit Ismail Dervishi, i datëlindjes 20.3.1963, si dhe caktimin e kujdestarit për administrimin e pasurisë së tij kërkuesen Mirela Balla (Dervishi), e datëlindjes 14.6.1965.

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë